



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05
Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 16 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për parashtime për rishikimin e paraburgimit

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit
Julius von Bone

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 41(10) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Salih Mustafës ("z. Mustafa"),² dhe nxori fletarrestimin kundër tij ("fletarrestimi")³ së bashku me urdhrin për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara.⁴

2. Më 24 shtator 2020, z. Mustafa u arrestua dhe transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.⁵

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

3. Në përputhje me nenin 41(10) të Ligjit, deri kur aktgjykimi merr formë të prerë ose deri në lirim, pasi të kenë kaluar dy muaj nga vendimi i fundit për paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ekzistojnë ende arsytet për paraburgim dhe merr vendim për zgjatjen ose përfundimin e paraburgimit.

¹ KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni publik i redaktuar i vendimit për konfirmimin e aktakuzës kundër Salih Mustafës*, 5 tetor 2020, publik.

³ KSC-BC-2020-05, F00009/A01/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni publik i redaktuar i fletarrestimit për z. Salih Mustafa*, 12 qershor 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2020-05, F00009/A02/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni publik i redaktuar i urdhrin për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 12 qershor 2020, publik.

⁵ KSC-BC-2020-05, F00013, Administratorja, *Njoftim i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00014, Administratorja, *Njoftim për pranimin në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

4. Në përputhje me rregullën 57(2) të Rregullores, pas caktimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe deri kur aktgjykimi merr formë të prerë, paneli i ngarkuar me çështjen e vlerëson vendimin për paraburgim pasi të kenë kaluar dy muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin, në përputhje me nenin 41(6), (10), (11) dhe (12) të Ligjit, ose në çdo kohë me kërkesë të të akuzuarit ose të Prokurorit të Specializuar, ose *proprio motu*, nëse që nga vlerësimi i fundit ka ndryshim të rrethanave.

III. DISKUTIM

5. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se z. Mustafa është në paraburgim që nga data 24 shtator 2020 dhe se nuk e ka kundërshtuar dhe as nuk ka kërkuar rishikimin e paraburgimit. Në këtë rast, si dhe në pajtim me nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, rivlerësimi dhe rishikimi i parë i paraburgimit të tij duhet të kryhet dy muaj pas zbatimit të vendimit të fundit për paraburgim, konkretisht, të fletarrestimit të lëshuar në përputhje me nenin 41(6) të Ligjit.

6. Përpara se të nxjerrë vendim *proprio motu* për rivlerësimin dhe rishikimin e paraburgimit të z. Mustafa, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton parashtrimet nga palët në këtë çështje.

IV. VENDIM

7. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kërkon nga palët që të dorëzojnë parashtrime me shkrim deri **në orën 12:00 të ditës së premte, 20 nëntor 2020**, nëse ekzistojnë ende arsyet për vazhdimin e paraburgimit të z. Mustafa apo paraburgimi duhet të përfundojë.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 16 nëntor 2020
Në Hagë, Holandë.